Në suazat e programit të diseminimit, aktivitetet do të orientohen drejt zgjerimit të njohurive për Lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, ndërtimit të sistemit për kryerjen e diseminimit të përgjithshëm të Së Drejtës humanitare ndërkombëtare (DHN) dhe diseminimit të Së Drejtës humanitare ndërkombëtare për grupet e veçanta qëllimore, promovimit dhe inkurajimit të aplikimit praktik të vlerave universale – jo dhunës dhe paqes, kulturës së dialogut, vlerave humane dhe promovimit të parimeve themelore të Lëvizjes, promovimit të metodave dhe veglave për forcimin e kapaciteteve dhe përparimit të diseminimit, forcimit të imazhit të shoqatës nacionale.



Plani strategjik i diseminimit 2018-2020

Do të promovohet dokumenti ku do të vendosen prioritetet e veprimit për periudhën e ardhshme 5 vjeçare që do të thotë se do të përfshijë potencialet dhe segmentet e veçanta strukturore dhe të institucionalizuara për promovimin e fuqisë së humanitetit, vlerave humane dhe të drejtës humanitare.

KRYQI I KUQ NË AKSION – PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE



“Kryqi i kuq në aksion – Promovimi i vlerave humane” (KKA-PVH) është vegël nacionale për tërheqjen dhe mbajtjen e vullnetarëve në radhët e Kryqit të kuq. Misioni i saj i përhershëm është promovimi i kulturës së dialogut si parakusht themelor për ndërtimin e shoqërisë ndërkulturore dhe promovimin e njohurive aktive dhe qasjes aktive ndaj jetës, përmes vlerave dhe parimeve të Kryqit të kuq. Programi është produkt vendor dhe tanimë 20 vjet funksionon në shoqërinë tonë dhe është krijuar në bazë të traditave, normave kulturore dhe vlerave lokale.

Programi KKA-PVH përmban krijimin e modelit të diseminimit për të rinjtë, promovimin e kulturës së dialogut, lidhjen e diseminimit me aktivitetet humanitare dhe rekrutimin dhe mbajtjen e vullnetarëve të rinj në Kryqin e kuq. Programi KKA-PVH ka në dispozicion 30 instruktorë nacionalë PVH të trajnuar, të cilët formojnë kolegjiun KKA-PVH, që për qëllim përfundimtar ka kultivimin e projektit.

Përmes ciklit KKA-PVH, në vitin 2018, për organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit do të ofrohet një opsion për të aplikuar dhe kotizuar për pjesëmarrje, ku pritet që nga një numër prej 800 të rinjsh të përpunohen rreth 120 projekte të vogla për mirëqenien e komunitetit në të cilin jetojnë, duke mundur direkt mbështetje për rreth 2.500 persona të grupeve të

ndryshme të rrezikuara në RM. Përmes implementimit të projekteve, shumica e këtyre personave do të marrin ndihmë dhe mbështetje për përmirësimin e kushteve të jetesës. Por, gjithashtu shumica e projekteve përbëhen nga donacionet/mbështetja për spitalet, qendrat ditore për personat me aftësi të kufizuar, shkollat, çerdhet e fëmijëve, objektet kulturore apo vendet publike, dhe përfaqësojnë një mbështetje të drejtpërdrejtë për komunitetet nga të cilat vijnë të rinjtë.

Në suaza të ciklit do të zhvillohen dy punëtori për përgatitjen e PVH-instrukturëve dhe do të realizohen 100 trajnime nga instruktorët dhe diseminatorët që do të trajnohen për ciklin e ardhshëm, si dhe një punëtori finale dyditëshe për 70 të rinj, ku të rinjtë më të mirë do të marrin njohuri të thelluara për Kryqin e kuq, punë ekipore, shkathtësi dhe kulturë lideri, si sistem vlerash. Në fund të ciklit do të jepet një trofe PVH, mirënjohje për të rinjtë që kanë punuar projektet më të mira, dhe do të organizohet java PVH gjatë së cilës të rinjtë do të promovojnë tolerancë, paqe dhe bashkëjetesë në vendin tonë.

Programi i të rinjve ofron mundësi për lidhjen e teorisë me praktikën dhe ndarjen e vlerave të ndryshme kulturore. Përmes tij promovohet qasja aktive ndaj jetës dhe ndryshohet rutina ditore e të rinjve.

PËRPARIMI DHE KULTIVIMI I VULLNETARIZMIT

Vullnetarizmi përfaqëson bazën e punës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, në të cilin bazohen të gjitha aktivitetet që KKRM-ja i implementon për grupet e veta qëllimore. Puna me vullnetarët në nivel lokal dhe nacional është rregulluar me shumë akte dhe zbatohet me vegla të ndryshme varësisht nga lloji i programit apo i aktivitetit. Në vitin 2018 do të bëhet një forcim shtesë i kapaciteteve në nivel lokal dhe nacional për të menaxhuar në mënyrë më efektive programet e vullnetarëve.

Aplikimi i softuerit për menaxhimin e vullnetarëve

Me të filluar viti do të fillojë mbajtja e unifikuar e evidencës së orëve dhe aktiviteteve të vullnetarëve në të gjitha organizatat komunale dhe në Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit, me një softuer të përgatitur enkas. Softueri do të mundësojë një monitorim të lehtë të angazhimeve të vullnetarëve, përvojat e marra, interesat e vetë vullnetarëve dhe do të kontribuojë në gjetjen e hapave të duhur për motivimin e individëve dhe grupeve të vullnetarëve.

Shënimi i Ditës botërore të vullnetarizmit 5 dhjetori

Në mënyrë tradicionale më 5 dhjetor, në nivel nacional do të zhvillohet ngjarja e dhënies së mirënjohjeve për individët dhe format e organizimit të punës vullnetare, të cilët i kanë arritur rezultatet më të mira gjatë vitit të kaluar.

Plani strategjik i vullnetarizmit i Kryqit të kuq të RM-së për vitin 2018-2020

Do të bëhet promovimi i dokumentit që do të përmbajë vendosjen e prioriteteve të veprimit për 5 vitet e ardhshme në fushën e zhvillimit dhe përpërimin të vullnetarizmit në Organizatë. Në përputhje me planin strategjik, për nevojat e kategorive të veçanta të vullnetarëve, gjatë vitit do të organizohen takime me përfaqësues të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit për ndarjen e përvojave dhe praktikave më të mira, si dhe do të iniciohen këmbime të përvojave me shoqatat tjera nacionale.



News Feed

Requests

Messages

Notifications

More

ME PARANDALIM PËR TË RUAJTUR DHE PËRMIRËSUAR SHËNDETIN

Aktivitetet parandaluese shëndetësore të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë përfshijnë ndihmën e parë, dhurimin e gjakut dhe programet për promovimin dhe parandalimin shëndetësor që adresojnë stigmën dhe diskriminimin, duke siguruar mbështetje psikosociale dhe mobilizim të komuniteteve.

Nëpërmjet implementimit të aktiviteteve shëndetësore – parandaluese të orientuara kryesisht drejt grupeve më të rrezikuara të popullsisë, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë do të synojë përparimin e shëndetit, si atë individual, ashtu edhe të komunitetit, të kontribuojë drejt përmirësimit të gatishmërisë së vendit për një reagim të shpejtë dhe efikas ndaj të gjitha sfidave shëndetësore, me një qasje shumë-disiplinore dhe ndër-sektoriale në punën e tij. Aktivitetet shëndetësore parandaluese janë orientuar drejt realizimit të Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm (QZHQ) për mirëqenien e të gjithëve në nivel global.

PARANDALIMI I SËMUNDJEVE INFEKTUESE DHE JO INFEKTUESE

Si partner i Ministrisë së Shëndetësisë, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në vazhdimësi ndërmer aktivitete për mbajtjen e prevalencës së ulur të HIV-it në Republikën e Maqedonisë. Duke u kujdesur për grupet më të rrezikuara të popullsisë, siç janë përdoruesit intravenozë të drogave në tri qendrat në Veles, Prilep dhe Kërçovë, nëpërmjet programeve për uljen e pasojave të dëmshme nga përdorimi i drogave, përpiqemi për të dhënë kontribut në uljen e rrezikut nga HIV/SIDA, hepatiti B dhe C dhe infektimet e transmetueshme përmes gjakut dhe seksualisht, mbidozimi dhe pasojat tjera shëndetësore dhe dëmet sociale, si dhe risocializimin dhe riintegrimin e përdoruesve të drogës në shoqëri.

Realizimi i ligjëratave edukative, shpërndarja e materialit informativ edukativ duke vënë theksin në grupet më të rrezikuara të popullsisë që kanë prirje për t'u sëmurë nga tuberkulozi, Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë do të vazhdojë aktivitetet për ngritjen e ndërgjegjes dhe njohurive tek popullsia për ekzistimin, parandalimin dhe mjekimin e kësaj sëmundjeje.

PLAKJA E SHËNDETSHME DHE AKTIVE

Plakja aktive dhe e shëndetshme është aspekti kryesor i shëndetit dhe mirëqenies. Gjendja shëndetësore është një faktor që ka efekt të fuqishëm në plakjen dhe është veçanërisht e rëndësishme për një plakje aktive. Organizata Shëndetësore Botërore thekson se plakja e shëndetshme në të vërtetë fillon me shprehitë dhe sjelljet e shëndetshme në fazat e hershme të jetës së njerëzve. Por asnjëherë nuk është tepër vonë për të filluar: për shembull, rreziku nga vdekja e parakohshme për të moshuarit zvogëlohet për pesëdhjetë për qind nëse ndërpresin pirjen e duhanit në moshën ndërmjet 60 dhe 75 vjeç. Për këtë qëllim, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë do të mbështesë realizimin e hulumtimeve dhe trajnimeve në fushën e shëndetësisë për të moshuarit dhe të kujdesit të përbashkët, përfshirjen e të moshuarve në planifikimin, implementimin dhe evalvimin shoqëror të aktiviteteve lokale shëndetësore, sociale dhe rekreative, si dhe do të promovojë në vazhdimësi shëndetin tek të moshuarit, dhe edukimin për efektet e dëmshme të pirjes së duhanit, alkoolit, ushqimit të keq dhe do të promovojë aktivitetin fizik.



SHËNDETI NË KUSHTE TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin e Shëndetit Publik, Institutin e Mjekësisë së Punës, Organizatën Shëndetësore Botërore – zyra në Shkup, si dhe institucione të tjera qeveritare dhe jo qeveritare të nivelit lokal dhe nacional, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në përputhje me planin e veprimit për valët e ngrohta, vazhdon zbatimin e aktiviteteve. Aktivitetet janë orientuar drejt mbrojtjes së shëndetit të popullsisë nga valët e ngrohta, ngritja e ndërgjegjes publike për pasojat e mundshme të tyre, si dhe edukimi për masat e mundshme parandaluese që çdo individ është në gjendje dhe duhet t'i ndërmerret me qëllim që të mbrojë shëndetin e tij dhe shëndetin e të afërmeve të tij.

Në përputhje me kushtet e motit gjatë periudhës së dimrit, duke marrë parasysh edhe nevojat e popullsisë, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është përgatitur për të reaguar në kohën e duhur, duke ndërmarrë aktivitete nga më të ndryshmet në drejtim të mbrojtjes së shëndetit të popullsisë nga pasojat që mund të paraqiten si rezultat i ekspozimit në temperatura të jashtme ekstreme të ftohta, duke vënë theksin në grupet më të rrezikuara të popullsisë, si personat e pastrehë, familjet e varfra në aspekt social, të moshuarit etj.

NDIHMJA E PARË NË DISPOZICION PËR SECILIN

Kryqi i kuq përpiqet që ndihma e parë të jetë në dispozicion për secilin. Synon që të paktën një person në çdo familje të jetë në gjendje për të mësuar shkathtësitë për dhënien e ndihmës së parë, pa marrë parasysh statusin e tij socio-ekonomik, apo faktorë të tjerë diskriminues. Si çdo vit, edhe sivjet, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë do të zbatojë një numër të madh aktiviteteve që do të jenë të drejtuara kah promovimi i ndihmës së parë në të gjitha segmentet e jetës duke i dhënë rëndësi të veçantë ndihmës së parë në komunikacion dhe në vendin e punës.

Qëllimi parësor i Shoqatës nacionale do të jetë forcimi i kapaciteteve ekzistuese materiale dhe njerëzore në sigurimin e shërbimeve efikase dhe cilësore në fushën e ndihmës së parë për grupe të ndryshme qëllimore, futjen e aktiviteteve të reja të programit dhe zhvillimin e atyre ekzistuese në fushën e ndihmës së parë, implementimin e tyre, promovimin dhe forcimin e bashkëpunimit të partneritetit. Këto qëllime, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë do t'i realizojë nëpërmjet: zbatimit të kurseve për ndihmën e parë për kandidatët për shoferë, kurse të ndihmës së parë për organizatat e punës, kurse të ndihmës së parë për grupe të ndryshme qëllimore (të moshuar, bebisiterë, anëtarët e rinj, institucionet shtetërore etj.), kurse për edukatorët dhe demonstruesit e rinj të licencuar, kurse freskimi të ndihmës së parë për edukatorë dhe demonstrues tanimë të licencuar, kurse për mjeshtër makijazhi për paraqitjen realiste të lëndimeve, kurse për gjykatës të licencuar për gara komunale dhe shtetërore të ndihmës së parë, pjesëmarrje në ushtrimet e simulimit me paraqitje realiste të lëndimeve në bashkëpunim me institucione të tjera qeveritare, implementimi i projekteve të fushës së ndihmës së parë, monitorimi i risive të ndihmës së parë në nivelin nacional dhe ndërkombëtar, shënimi i Ditës botërore të ndihmës së parë, shënimi i Ditës botërore të viktimeve të fatkeqësive të komunikacionit, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar me shoqatat tjera nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në fushën e ndihmës së parë.

Realizimi i këtyre aktiviteteve duhet të kontribuojë në rritjen e numrit të kuadrit të edukuar për realizimin e programeve mësimore të ndihmës së parë, rritjen e resurseve të kuadrit dhe ato materiale për realizimin e aktiviteteve të fushës së ndihmës së parë, futjen e përmbajtjeve të reja mësimore për grupet e ndryshme qëllimore, futjen e modeleve të reja të organizimit të grave komunale dhe shtetërore të ndihmës së parë, ngritjen e ndërgjegjes së



popullsisë për rëndësinë e marrjes së njohurive për ndihmën e parë, rritjen e numrit të vullnetarëve, sigurimin e ndihmës dhe shërbimeve më cilësore për grupet qëllimore, rritjen e kapacitetit të grupeve të rrezikuara për të dhënë ndihmë të parë dhe forcimin e kontributit të partneritetit në implementimin e aktiviteteve të programit në fushën e ndihmës së parë.

Sigurimi i edukatës së bazuar në cilësi dhe shkencë për ndihmën e parë në dispozicion për secilin, do të kontribuojë për ndërtimin e bashkësive të sigurt dhe të shëndetshme nëpërmjet parandalimit dhe reduktimit të rreziqeve në fatkeqësitë e përditshme dhe katastrofat. Trajnimi për ndihmën e parë është një vegël e vlefshme për ndërtimin e kulturës së vërtetë të parandalimit nga e cila do të ketë përfitim bashkësia e gjithmbarshme.

Ndërmarrja e aktiviteteve në kohën e duhur dhe aplikimi i masave të drejta dhe përkatëse për dhënie të ndihmës së parë është e rëndësishme në shpëtimin e jetës së njerëzve.



Plani strategjik i veprimtarisë shëndetësore parandaluese 2018-2020

Do të mbahet promovimi i dokumentit që ka për qëllim të ndihmojë në uljen e pabarazive shëndetësore, për të vënë fokusin në promovimin shëndetësor dhe për të përparuar informimin shëndetësor.

MOS PRIT TË NDODH FATKEQËSIA, DHURO GJAK

Dhurimi vullnetar i gjakut në Republikën e Maqedonisë ka një qëllim të vetëm, e ky është motivimi i një numri sa më të madh të njerëzve në mënyrë vullnetare të dhurojnë gjak që të mundësohet mbledhja e sasive të nevojshme të gjakut dhe komponentëve të gjakut që janë të domosdoshme për mjekimin e të sëmurëve dhe të lënduarve. Dhurimi i gjakut i zhvillon karakteristikat e humanitetit dhe solidaritetit dhe ka rëndësi edukative tek qytetarët, sidomos tek të rinjtë, kontribuon për ngritjen e nivelit të kulturës shëndetësore dhe ndërgjegjes publike. Për këto arsye motivimi i popullsisë për dhurim vullnetar të gjakut është jashtëzakonisht i rëndësishëm për ndërtimin e marrëdhënieve pozitive ndaj dhurimit të gjakut.

Gjaku si ilaç akoma është i pazëvendësueshëm dhe marrja e tij varet vetëm nga vullneti i njerëzve që dhurojnë gjak, të cilët në mënyrë vullnetare, anonime, falas dhe në mënyrë solidare dhurojnë gjak. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë dhe Instituti i Mjekësisë së Transfuzionit nëpërmjet motivimit dhe promovimit të dhurimit vullnetar të

gjakut me një aktivitetet të planifikuar, masiv dhe të vazhdueshëm do të sigurojë sasitë e nevojshme të gjakut dhe komponentët e gjakut, vazhdimisht do të inkurajojë ndërgjegjen publike për rëndësinë dhe domethënien e dhurimit të gjakut dhe do të kryejë një aktivitet të duhur dhe të drejtuar shëndetësor-edukativ dhe motivues.

Programi për organizimin dhe përparimin e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë dhe Ligji i sigurisë në furnizimin me gjak, do të zbatohen përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm dhe të përhershëm me Institutin e Mjekësisë së Transfuzionit gjatë vitit, dhe shumica e aktiviteteve do të zbatohen nga një ekip i përbashkët koordinues, i cili punon në planifikimin dhe organizimin e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë, monitoron dhe koordinon të gjitha aksionet e dhurimit të gjakut të parapara me planin vjetor integral për organizimin e aksioneve të dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë, jep këshilla dhe rekomandime profesionale për organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe shërbimet e mjekësisë së transfuzionit. Për realizimin e suksesshëm të Programit të dhurimit të gjakut gjithashtu me rëndësi është bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë.

Për promovim të suksesshëm të dhurimit vullnetar të gjakut, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, në vazhdimësi përgatit materiale shëndetësore-edukative dhe propaganduese, mirënjohje jubilarë për dhuruesit e gjakut, zbaton anketa, organizon ligjërata, tribuna dhe fushata me grupe të ndryshme qëllimore, organizon seminare dhe punëtori edukative të motivuesve për dhurim vullnetar të gjakut, zbaton aktivitete në përputhje me Planin strategjik të dhurimit të gjakut për vitin 2018-2022 dhe me Politikën e dhurimit të gjakut të vitit 2013, informon popullsinë për aktivitetet nëpërmjet ueb-faqeve të dy institucioneve dhe E-gazetës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, mban evidencë elektronike dhe të shkruar për dhuruesit e gjakut dhe përgatit raporte mujore, periodike dhe vjetore.



Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë vëmendje të madhe i kushton punës vullnetare të Klubeve të dhuruesve të gjakut me qëllim që të mobilizohen një numër sa më i madh i dhuruesve të gjakut, të cilët rregullisht informohen për të gjitha aktivitetet dhe problemet me të cilat ata përballen në veprimtarinë e dhurimit të gjakut. Aktivitetet e Klubeve 25 të rinjve dhe dhuruesve potencialë të gjakut të Shkupit, Manastirit dhe Ohrit janë popullarizuar me qëllim të rritjes së numrit të tyre, rekrutimit dhe mbajtjes së duhur në procesin e dhurimit të gjakut dhe krijimit të rrjetit të dhuruesve të rinj të gjakut për kryerjen e promovimit dhe motivimit të dhuruesve të rinj të gjakut në institucionet arsimore.



Qendrat ditore të dhurimit të gjakut

Në bashkëpunim me Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit do të realizohen dhurimet e planifikuara me vetë-iniciativë të gjakut, do të organizohen aktivitete promovuese dhe aksione të vogla të dhurimit të gjakut.

Shënimi i ngjarjeve

Me aktivitete të rastit dhe të promovimit, do të shënohet 17 marsi – Dita e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë dhe 14 qershori – Dita botërore e dhurimit të gjakut. Si çdo vit do të ndërmerren të gjitha masat dhe aktivitetet për organizimin e numrit të mjaftueshëm të aksioneve të rregullta dhe tradicionale të dhurimit të gjakut me qëllim që në vazhdimësi të sigurohen sasitë e nevojshme të gjakut dhe komponentët e gjakut në dispozicion për të gjithë qytetarët që kanë nevojë të domosdoshme për të, në mënyrë që të kontribuojmë në ndërtimin e bashkësive të sigurta dhe të shëndetshme.

Plani strategjik i dhurimit të gjakut 2018-2020

Do të promovohet dokumenti që do të përmbajë vendosjen e prioriteteve të veprimit për periudhën e ardhshme 5-vjeçare për motivimin dhe avancimin e dhurimit të gjakut.



TË GATSHËM PËR ÇDO SFIDË

Aktivitetet në planin e gatishmërisë dhe veprimit në katastrofa do të orientohen drejt forcimit të kapaciteteve dhe tejkalimit të pasojave të situatave të krizës në përputhje me qëllimet e agjendës globale të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Aktivitetet parësore në këtë veprimtari do të drejtohen kah ulja e rreziqeve, forcimi i rezistencës së organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit në bashkëpunim me bashkësinë lokale, si dhe forcimi i kapaciteteve të resurseve njerëzore.

Aktivitetet do të realizohen në bashkëpunim me shoqatat nacionale të Kryqit të kuq të rajonit, si dhe me Qendrën për Menaxhim me Kriza dhe Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim të cilat janë agjenci udhëheqëse në RM. Theks i veçantë do të vihet mbi kapacitetet dhe rolin e Kryqit të kuq të RM-së në koordinim dhe komunikim me pushtetin lokal në rast të katastrofave. Do të vazhdojë trendi i bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes së RM-së për promovimin e aktiviteteve të KKRМ-së për gatishmërinë dhe veprimin në katastrofa dhe diseminimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare me theksin e vënë në dispozitat e Konventave të Gjenezës dhe Protokollet Shtesë.

Do të fillojë definimi i programeve të trajnimit në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare për vullnetarët e Kryqit të kuq, organet e administrimit, edukatorët dhe anëtarët e ekipeve të reagimit në katastrofa. Programet e trajnimit për reagim në katastrofa do të azhurnohen dhe do të implementohen në suaza të dy trajnimeve të planifikuara për vullnetarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

Forcimi i rezistencës së komuniteteve në rast të katastrofave, nuk është komponentë e administrimit vetëm me katastrofat por në përgjithësi me të gjitha programet e zhvillimit për situatat e krizës. Në kuadër të aktiviteteve të kësaj sfere janë planifikuar aktivitete të konsiderueshme për uljen e rreziqeve nga katastrofat që do të zbatohen në bashkëpunim me partnerët tjerë në formë të ushtrimeve të përbashkëta simuluese në përputhje me rreziqet e vlerësuara në komunitetet.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes lokale, Qendrën për Menaxhim me Kriza, Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, do të punojë në ngritjen e ndërgjegjes publike tek rinia e shkollave të mesme për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në rast të katastrofave, si dhe duke filluar aktivitete në çerdhet e fëmijëve. Për këtë qëllim do të përgatitet një kuiz elektronik me vetë-testim nga fusha e katastrofave që do të ketë karakter edukativ.



Shpëtimi në ujëra të hapura dhe të mbyllura

Kryqi i kuq përmes qendrave profesionale të sigurisë në ujë, do të organizojë kurse për shpëtimtarë dhe instruktorë në ujëra të hapura dhe të mbyllura. Do të vendoset një bashkëpunim dhe do të nënshkruhen marrëveshje me koncesionerët e zonave të largjes të cilët do të angazhojnë shpëtimtarë në ujë për të punuar gjatë periudhës së verës. Në planin ndërkombëtar, na presin një sërë aktivitete për forcimin e bashkëpunimit me Kryqin e kuq të Bullgarisë dhe Kroacisë, duke vënë theksin në organizimin e kurseve të përbashkëta për shpëtimtarë dhe instruktorë në ujëra të shpejta.

Ndihma dhe mbështetja për migruesit dhe refugjatët

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë do të vazhdojë asistencën mjekësore dhe humanitare për migruesit dhe refugjatët, të cilët qëndrojnë në qendrat tranzitore për refugjatë/migrues në Tabanoc (Kumanovë) dhe Vinojug (Gjevgjeli), si dhe migruesit e parregullt në Llojan dhe Vaksincë dhe në Qendrën e pritjes për të huajt – Gazi Babë, si dhe për uljen e preksshmërisë së grupeve qëllimore. Për këtë qëllim do të forcohen dhe koordinohen aktivitetet në bashkëpunim me të gjitha organizatat e përfshira qeveritare dhe jo qeveritare që janë të pranishme në terren. Ekipet e Kryqit të kuq do të vazhdojnë të japin mbështetje logjistike, asistencë, ofrim të ndihmës së parë, shpërndarje të ushqimit etj., dhe rivendosjen e lidhjeve familjare.

Ekipet mobile të Kryqit të kuq përveç qasjes humanitare ndaj migruesve/refugjatëve, do të synojnë ndërtimin e një bashkëpunimi me popullsinë lokale duke hapur klube të rinjve në shkollat fillore në disa fshatra të Komunës së Likovës, duke zhvilluar punëtori në bashkëpunim me Policinë kufitare, duke ngritur ndërgjegjen për praninë e migruesve, si dhe duke ndihmuar familjet e rrezikuara në aspekt social.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme në Qendrën e pritjes për të huajt – Gazi Babë, Kryqi i kuq do të vazhdojë të sigurojë mbrojtje primare shëndetësore, triazh të migruesve në këtë qendër dhe ndërmjetësimin në nivel sekondar dhe terciar. Do të sigurohen ilaçet e nevojshme në bazë javore dhe ndihma humanitare në produkte ushqimore dhe jo ushqimore. Në bazë të indikatorëve aktualë për personat e pranishëm në Qendrën e pritjes për të huajt – Gazi Babë, në bazë mujore do të asistohet për 50 persona (numri mesatar i personave përkohësisht të akomoduar në këtë qendër).

Plani strategjik për gatishmërinë dhe veprimin në katastrofa 2018-2020

Gjatë vitit do të promovohet dokumenti ku janë përmbajtur prioritetet e veprimit për periudhën e ardhshme 5-vjeçare për vendosjen e qasjeve të reja të menaxhimit të katastrofave.



RIVENDOSJA E LIDHJEVE FAMILJARE

Rivendosja e lidhjeve familjare është një nocion i gjerë për aktivitetet që kanë për qëllim parandalimin e ndarjes dhe zhdukjes së një personi të caktuar dhe rivendosjen e kontaktit me anëtarët e familjes. Në këtë proces bën pjesë edhe ndriçimi i fatit të personit që evidentohet si i zhdukur.

Aktivitetet në planin e rivendosjes së lidhjeve familjare të komponentëve të Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, janë të themeluara në Konventat e Gjenevës së vitit 1949 dhe në Protokollat Shtesë të vitit 1977, në Statutin e Lëvizjes dhe në Rezolucionet e Konferencës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe në Këshillin e Delegatëve. Fuqia e Lëvizjes kryesisht qëndron në potencialin e saj për të siguruar një rrjet nëpër gjithë botën.

Komponentët e ndryshëm të Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe me dekada bëjnë përpjekje të jashtëzakonshme në këtë plan. Duke potencuar përvojën dhe vazhdimësinë e aktiviteteve të Shërbimit për kërkesa të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, është e pranishme ndërgjegjja dhe vullneti për një qasje të mëtejshme strategjike dhe zhvillim të kapaciteteve të veta dhe marrëdhënieve të partneritetit.

Nga e gjithë kjo del nevoja për ndërtim të vazhdueshëm të kapaciteteve në të gjitha nivelet e veprimit të Shërbimit për kërkesa, për të arritur një përgjigje efektive dhe të mjaftueshme të nevojave humanitare të popullsisë për rivendosjen e lidhjeve familjare.

Aktivitetet në vitin 2018 janë orientuar drejt zgjidhjes së rasteve për rivendosjen e lidhjeve familjare lidhur me krizën e migruesve që është aktuale viteve të fundit. Për këtë qëllim është e nevojshme të mundësohet vazhdimi i mbështetjes logjistike të ekipeve të Shërbimit për kërkesa. Përgatitja e raporteve dhe statistikave mujore dhe dërgimi i tyre në kohën e duhur deri te Qendra rajonale informative për rivendosjen e lidhjeve familjare në Beograd; Formimi i një ekipi për rivendosjen e lidhjeve familjare në kuadër të Njësisë për reagim në katastrofa të Kryqit të kuq të RM-së dhe organizimi i trajnimit për të njëjtën, në kuadër të planit për trajnime në rast të katastrofave të shoqatës nacionale, me qëllim të pranisë së Shërbimit për kërkesa si pjesë përbërëse e këtij aktiviteti programor të Kryqit të kuq të RM-së; Prania e Shërbimit për kërkesa në takimet ndërkombëtare, për të monitoruar dhe përparuar programet e rivendosjes së lidhjeve familjare në kuadër të shoqatave nacionale; Ndërtimi i raportit adekuat me Qeverinë dhe institucionet qeveritare dhe organizatat partnere në terren, për të realizuar në mënyrë më të suksesshme aktivitetet e Shërbimit për kërkesa.



NDIHMË PËR SECILIN DHE KUDO

Sigurimi i shërbimit përkatës dhe cilësor për përdoruesit, forcimi i kapaciteteve materiale dhe ndërtimi i resurseve njerëzore, janë qëllimet parësore që dalin nga Plani strategjik i veprimtarisë sociale-humanitare të organizatës. Në bazë të prioriteteve të përcaktuara të veprimit, Kryqi i kuq gjatë vitit do të ndërmarrë masa dhe aktivitete përkatëse për inkurajimin e përfshirjes sociale të grupeve të rrezikuara qëllimore të popullsisë së ballafaquar me rreziqe të caktuara sociale.

Kryqi i kuq i RM-së si ndihmës i Qeverisë, përmes veprimit të tij përfshihet dhe kontribuon për të ndikuar si partner mbi uljen e preksshmërisë dhe të përjashtimit social të popullsisë. Anëtarësimi në trupat nacionalë të Qeverisë, Trupit koordinues nacional për monitorimin dhe evalvimin e Strategjisë nacionale për të moshuarit, Këshillit për siguri sociale dhe Sekretariatit në Komisionin nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrim ilegal, kontribuon për përfshirjen e drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrjen aktive të Kryqit të kuq në krijimin dhe zbatimin e strategjive nacionale. Gjithashtu përfshirja në përgatitjen e planeve nacionale të veprimit në segmente të caktuara të mbrojtjes sociale përfaqëson konfirmim të kapaciteteve të organizatës së Kryqit të kuq.

Për të realizuar aktivitetet sociale – humanitare, Kryqi i kuq, përveç me institucionet qeveritare, gjatë vitit do të realizojë bashkëpunim me sektorin civil, si dhe me sektorin e biznesit në Maqedoni. Implementimin e aktiviteteve në nivel lokal, Kryqi i kuq do ta bëjë për dhe me grupet e rrezikuara qëllimore në komunitetet, me qëllim që të mundësohet një qasje pjesëmarrëse në marrjen e vendimeve që direkt ndikojnë në jetën e tyre.



Kujdesi dhe mbështetja për të moshuarit

Një nga aktivitetet e rëndësishme të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë është siguri i mbështetjes për të moshuarit, si dhe zhvillimi i aktiviteteve për inkurajimin e plakjes aktive. Mbështetur nga Kryqi i kuq i Austrisë, si dhe me mbështetjen e partnerëve të sektorit të korporatave vazhdimisht do të zbatohen dhe zhvillohen aktivitetet e projektit të kujdesit për personat e moshuar në shtëpi. Përmes ofrimit të shërbimeve përkatëse nga ana e vullnetarëve të Kryqit të kuq dhe infermiereve të angazhuara përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit do të sigurohet mbështetje në përmbushjen e nevojave parësore për të moshuarit e vetmuar dhe të pafuqishëm në kushte shtëpiake, të cilët janë ballafaquar me rreziqe sociale. Qendrat e kujdesit ditor për të moshuarit që funksionojnë përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe Organizatës komunale të

Kryqit të kuq – Gazi Babë, si dhe klubet e të moshuarve që funksionojnë përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq – Kriva Pallankë, Negotinë, Veles dhe Prilep, përfaqësojnë një formë të organizuar të mbështetjes për të moshuarit dhe ato gjatë vitit do të zhvillohen në bashkëpunim dhe mbështetje të institucioneve qeveritare dhe sektorit të korporatave.

Kryqi i kuq i RM-së në vitin 2017 është verifikuar si një organizatë që zbaton trajnime për kujdestarë/e për personat e moshuar dhe të pafuqishëm. Trajnimet në përputhje me kandidatët e interesuar do të zbatohen edhe gjatë vitit 2018. Në bazë të mbështetjes së siguruar të projektit, Kryqi i kuq i RM-së do të zbatojë trajnime falas për grupet e rrezikuara qëllimore të popullsisë, të cilat do të aftësohen profesionalisht për të dhënë shërbime cilësore për personat e moshuar në kushte shtëpiake, dhe në këtë mënyrë do të bëhen më konkurrentë në tregun e punës.

Bashkëpunimi rajonal për përfshirjen sociale të personave të moshuar

Projekti rajonal “Ndërmarrja e aksionit për përfshirjen sociale të personave të moshuar”, financuar nga Bashkimi Evropian, dhe i mbështetur financiarisht nga Kryqi i kuq i Austrisë dhe Agjencia Austriake e Zhvillimit, i cili filloi të implementohet në vitin 2016, do të implementohet edhe gjatë vitit 2018, deri në janar të vitit 2019. Aktivitetet e projektit janë koordinuar nga ana e Kryqit të kuq të Serbisë dhe implementimi i tyre është bërë në partneritet me Kryqin e kuq të Maqedonisë dhe Shoqatës civile “Humanost” nga Maqedonia, Kryqi i kuq i Malit të Zi dhe shoqatat civile të Shqipërisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Qëllimi i projektit është implementimi i aktiviteteve nga rrjetat e krijuar rajonale të shoqatave civile dhe organizatat e Kryqit të kuq të pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor, me qëllim që të rritet ndërgjegjja publike dhe ndikimet pasuese në proceset e vendimmarrjes për përfshirjen sociale të personave të moshuar. Në Maqedoni aktivitetet janë implementuar përmes nëntë anëtarëve të rrjetit – InkluzivaM, që është formuar më 3 qershor të vitit 2016 në kuadër të projektit për përfshirjen sociale të personave të moshuar, përmes 12 shoqatave civile në Maqedoni të cilat janë mbështetur financiarisht në kuadër të aktiviteteve të projektit. Në bazë të hulumtimit për nevojën e hapjes së shërbimeve për mbështetje sociale dhe shëndetësore të personave të moshuar në kushte shtëpiake, do të përgatitet Strategjia e përfaqësimit me qëllim që të ndikohet në vendimmarrjen e institucioneve qeveritare për hapjen dhe mbështetjen e shërbimeve të tilla. Përmes anëtarëve të rrjetit Inkluziva M gjatë vitit në përputhje me planin e veprimit do të bëhet implementimi i aktiviteteve për përfshirjen sociale të personave të moshuar.

Zhvillimi i përbashkët i komuniteteve

Projekti Zhvillimi i përbashkët i komuniteteve (ZHPK) i mbështetur nga Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, gjatë vitit do të vazhdojë implementimin e tij përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq Qendër dhe Negotinë në dy komunitete të rrezikuara në të cilat jeton popullsi rome. Në bazë të vlerësimit të bërë për nevojat dhe prioritetet e verifikuara të komuniteteve, do të bëhet implementimi i mikro-projekteve për të inkurajuar zhvillimin e përbashkët të komuniteteve. Dy ekipet e formuara nga përfaqësues të Kryqit të kuq, institucionet qeveritare, sektori civil, si dhe përfaqësues të komuniteteve të rrezikuara, janë konfirmim i bashkëpunimit dhe veprimit të partneritetit në komunitetet. ZHPK është një vegël e punës që mundëson përfshirjen e personave të rrezikuar për

të marrë vendime se si të zgjidhin problemet e tyre.



Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta dhe mbështetja psikosociale e fëmijëve në familjet kujdestare

Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta është aktivitet i vazhdueshëm të cilin Kryqi i kuq e implementon në bashkëpunim me Entin për Veprimtari Sociale përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq – Veles, Prilep, Kavadar, Dellçevë, Dibër, Kërçovë dhe Gostivar. Aktivitetet e projektit, duke filluar nga viti 2011 janë mbështetur nga SHA Banka Komerciale dhe implementimi i tyre është bërë në bashkëpunim me qendrat ditore për fëmijët me nevoja të veçanta. Me aktivitetet e projektit është siguruar edhe mbështetja psikosociale për fëmijët në familjet kujdestare në Shkup, Veles dhe Prilep. Për të siguruar një qasje më të mirë dhe për të marrë shkathësi dhe dituri të dhura për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, do të organizohen punëtori edukative për forcimin e kapaciteteve të

vullnetarëve të Kryqit të kuq.

Do të bëhen përpjekje për vazhdimin e implementimit të aktiviteteve për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta me mbështetjen edhe të kompanisë Makprogres nga Vinica, e cila i mbështeti ato në vitin 2017, si dhe të zhvillohen dhe të zgjerohen në bashkëpunim dhe partneritet edhe me kompani të tjera të vendit.

Lufta kundër tregtisë me njerëz

Kryqi i kuq i RM-së si anëtar i Sekretariatit të Komisionit nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrim ilegal, jep kontribut aktiv në luftën kundër tregtisë me njerëz e cila përfaqëson një problem global që reflektohet edhe në vendin tonë. Gjatë vitit përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq do të bëhet implementimi i aktiviteteve parandaluese për edukim moshatarësh të vullnetarëve nga organizatat komunale të Kryqit të kuq në mjediset e veta përmes leksioneve të organizuara edukative parandaluese në shkollat fillore dhe të mesme. Aktivitetet parandaluese janë orientuar drejt ngritjes së ndërgjegjes së të rinjve për mënyrat nëpërmjet të cilave të rinjtë mund të jenë përfshirë në tregtinë me njerëz dhe për vetëmbrojtjen e tyre. Gjatë vitit, Kryqi i kuq i RM-së do të përfshihet në shënimin e Ditës evropiane dhe Javës së luftës kundër tregtisë me njerëz, në kuadër të të cilave do të organizohen punëtori edukative, teatro forume, si dhe ngjarje publike.

Donacionet për sigurimin e ndihmës

Me qëllim të rritjes së kapacitetit të shoqatës nacionale për të reaguar ndaj sfidave për përmbushjen e nevojave të caktuara të grupeve të rrezikuara qëllimore të komuniteteve, do të organizohen dy aksione të mëdha humanitare në kuadër të shënimin të Javës së solidaritetit dhe Ditës botërore të luftës kundër varfërisë dhe urisë. Në këto aksione do të sigurohet ndihmë në ushqim, veshmbathje, mjete të higjienës, si dhe donacione në mjetet financiare dedikuar për të ndihmuar personat e rrezikuar të përjashtuar në aspekt social të cilët kanë nevojë të domosdoshme për një lloj të tillë të mbështetjes.

Plani strategjik i veprimtarisë sociale-humanitare 2018-2020

Do të bëjë promovimin e dokumentit në të cilin janë përcaktuar prioritetet e veprimit në periudhë prej 3 vjetësh. Në përputhje me prioritetet e veprimtarisë sociale humanitare, janë përcaktuar qëllimet strategjike sipas së cilave janë definuar aktivitetet zhvillimore në drejtim të reduktimit të varfërisë dhe përfshirjes sociale të grupeve të rrezikuara qëllimore të popullsisë.



TË RINJTË JANË MOTORI AKTIVITETEVE

Të rinjtë e Kryqit të kuq do të konfirmojnë rolin e tyre si motori i aktiviteteve në të gjitha aktivitetet e Shoqatës nacionale në terren, si iniciatorë të ideve të reja dhe si liderë në mjediset e tyre të veprimit. Me qasjen e tyre proaktive dhe gatishmërinë për t'u ballafaquar me sfidat e reja, ata do të jenë një pjesë e rëndësishme e Shoqatës nacionale në arsyetimin e epitetit të marrë si shoqatë nacionale "e fortë", e gatshme për të reaguar ndaj sfidave humanitare të popullsisë lokale.



Forcimi i sistemit të edukimit të bashkëmoshatarëve për të rinjtë

Gjatë periudhës së verës do të mbahet një trajnim për trajnerë të edukatorëve të bashkëmoshatarëve për të forcuar kapacitetet e Shoqatës nacionale për trajnimin e edukatorëve të rinj të bashkëmoshatarëve për të rinjtë, në përputhje me nevojat e klubeve të të rinjve. Me këtë trajnim do të kontribuohet në qëndrueshmëri më të madhe të programeve parandaluese të cilat zhvillohen me të rinjtë.

Programi Kryqi i kuq në aksion – promovimi i vlerave humane

Programi mbetet edhe më tej vegla udhëheqëse në rekrutimin dhe motivimin e vullnetarëve të rinj, dhe promovimi dhe implementimi i tij përfaqëson një nga prioritetet kryesore në punën e të rinjve. Me modelin e tij të ri, i përshtatur për situatat aktuale në organizatat komunale dhe rrethinën, programi do të zbatohet përmes organizatës komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

Fushata për promovimin e aktiviteteve të të rinjve në Kryqin e kuq

Në kuadër të shënimit të Javës kalendarike të të rinjve më 01-07 tetor, do të organizohet një fushatë për promovimin e aktiviteteve të të rinjve për të tërhequr vullnetarë dhe bashkëpunëtorë potencialë. Fushata do të përfshijë evenimente publike të organizuara nga klubet e të rinjve, publikime promovimi,

imi, drejtime të promovimit përmes rrjetave sociale etj.

Organizimi i kampeve verore për forcimin e kapaciteteve të liderëve dhe përfaqësuesve të Këshillit të të rinjve

Në periudhën e verës në mënyrë tradicionale do të organizohen kampe verore për liderët në klubet e të rinjve për të marrë njohuri dhe shkathtësi për organizimin e të rinjve në klubet e tyre, mbajtjen e takimeve, krijimin e aktiviteteve, bartjen efektive të informacioneve, njohjen më të mirë me strukturën e shoqatës nacionale, ngritjen e iniciativave në nivel lokal dhe nacional, krijimin e planeve dhe raporteve vjetore, njohjen me dokumentet relevante të cilat rregullojnë punën e të rinjve në kuadër të Lëvizjes, Shoqatës nacionale, si dhe në shtet, dhe gjëra të tjera që kanë rëndësi të madhe për punën në klubet e të rinjve.

Plani strategjik për të rinjtë e Kryqit të kuq të RM-së për vitin 2018-2022

Do të shënojë promovimin e dokumentit i cili ngërthen vendosjen e prioriteteve të veprimit për periudhën e ardhshme 5-vjeçare në fushën e zhvillimit dhe përparimit të veprimit të të rinjve në organizatë.

MOBILIZIMI I FONDEVE NGA SEKTORI I KORPORATAVE

Promovimi i vlerave të programit para sektorit të korporatave, duke potencuar njëkohësisht përfitimet nga partneriteti me Kryqin e kuq, është një nga format e rëndësishme të mbështetjes dhe një mundësi për vendosjen e bashkëpunimit të partneritetit me kompanitë për implementimin e aktiviteteve të Kryqit të kuq.

Në përputhje me prioritetet strategjike të veprimit të organizatës për mobilizimin e fondeve nga sektori i korporatave, aktivitetet do të orientohen drejt avancimit të bashkëpunimit me kompanitë dhe rritjes së kapacitetit të Shoqatës nacionale për mobilizimin e fondeve. Kapacitetet e forcuara të organizatës do të kontribuojnë veçanërisht në zhvillimin e bashkëpunimit me sektorin e korporatave si në nivel nacional, ashtu edhe në atë lokal, për vendosjen e relacioneve afatgjate të partneritetit mbështetës në implementimin e përbashkët të programeve të dobishme shoqërore.

Forcimi dhe vendosja e bashkëpunimit të partneritetit me sektorin e korporatave

Kryqi i kuq i RM-së me veprimin e tij realizon një bashkëpunim dhe partneritet të frytshëm me shumë kompani të vendit, të cilat si kompani të përgjegjshme shoqërore tregojnë interesim dhe gatishmëri për një bashkëpunim dhe mbështetje për zbatimin e aktiviteteve humanitare të Kryqit të kuq. Gjatë vitit 2018 do të realizohet një bashkëpunim i vazhdueshëm i partneritetit me kompanitë, për të mbështetur implementimin e aktiviteteve të programit dhe projektit, si dhe iniciativat e përbashkëta në komunitetet.

Inkurajimi i interesimit të kompanive për bashkëpunimin dhe mbështetjen e partneritetit

Për të verifikuar interesimin e kompanive për bashkëpunim dhe për mbështetjen e aktiviteteve të projekti dhe programit të Kryqit të kuq, gjatë vitit do të bëhet hartografimi i interesimit të kompanive në bashkëpunim me organizatat komunale të Kryqit të kuq në vend. Kryqi i kuq i RM-së do të sigurojë mbështetje për organizatat komunale në vendosjen e komunikimit me kompanitë për një bashkëpunim dhe mbështetje të mundshme të partneritetit. Gjithashtu do të organizohen edhe takime për të këmbyer përvojat pozitive nga bashkëpunimi me kompanitë në nivelin lokal.

Bashkëpunimi me odat ekonomike

Për të bërë implementimin e iniciativave të përbashkëta të përcaktuara në memorandumet e nënshkruara të bashkëpunimit, kultivohet dhe zhvillohet bashkëpunimi i vendosur me Odën ekonomike të RM-së, Lidhjen e odave ekonomike të RM-së dhe Odën ekonomike të Maqedonisë veriperëndimore, në drejtim të promovimit të përgjegjësisë shoqërore të korporatave për mbështetjen e tyre në realizimin e programeve dedikuar për grupet e rrezikuara qëllimore të popullsisë. Gjithashtu do të zhvillohet bashkëpunimi edhe me Odën ekonomike Ameri-



kane, me të cilën Kryqi i kuq i RM-së ka realizuar një bashkëpunim të frytshëm gjatë viteve të kaluara.

Takimi i partneritetit

Kryqi i kuq i RM-së do të organizojë Takimin e 9-të të partneritetit me përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare, dhe sektorin e korporatave. Qëllimi i takimit është të inkurajohet bashkëpunimi ndërmjet Kryqit të kuq dhe organizatave partnere, të vendoset një partneritet i qëndrueshëm dhe të sigurohet mbështetja e projektit për programet shoqërore për përmirësimin e cilësisë së jetës së kategorive të rrezikuara të komuniteteve. Për këtë qëllim do të përgatitet një katalog i projekteve i cili do t'u ofrohet partnerëve për të dhënë mbështetje dhe për t'u përfshirë në implementimin e përmbajtjeve të projektit.

Dhënia e mirënjohjeve të Kryqit të kuq për bashkëpunimin dhe mbështetjen e partnerëve

Kryqi i kuq do të japë mirënjohje për partnerët e tij të sektorit të korporatave në shenjë falënderimi për bashkëpunimin dhe mbështetjen në realizimin e qëllimeve humanitare të tij. Janë këto kompani të cilat praktikojnë një punë të përgjegjshme shoqërore si pjesë përbërëse e politikës afariste. Këto mirënjohje jepen në ngjarje rasti me qëllim për t'i dhënë rëndësi bashkëpunimit të vendosur të partneritetit dhe për të motivuar kompanitë për të dhënë mbështetje të mëtejshme për Kryqin e kuq në implementimin e aktiviteteve të projektit dhe programit.

Plani strategjik i mobilizimit të fondeve nga sektori i korporatave 2018-2020

Do të bëhet promovimi i dokumentit në të cilin janë përcaktuar prioritetet e veprimit në periudhë prej 3 vjetësh, 2018 - 2020. Në përputhje me prioritetet e planit strategjik, janë përcaktuar qëllimet strategjike sipas së cilave janë definuar aktivitetet zhvillimore në drejtim të rritjes së kapacitetit të Shoqatës nacionale për mobilizimin e fondeve dhe përparimin e bashkëpunimit me partnerët e sektorit të korporatave në nivelin nacional dhe lokal, për të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për ndryshime pozitive në bashkësitë e rrezikuara.



PUNA MATERIALE – FINANCIARE

Në buxhetin e tij, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë qartë paraqet të ardhurat dhe shpenzimet vjetore, të cilat mundësojnë konstruktimin e mënyrës së financimit të organizatës dhe paraqesin mundësinë e zbatimit të një aktiviteti, strategjije dhe plani të caktuar.

Buxheti i përgjithshëm për vitin 2018 është zvogëluar për 47,48 % në krahasim me Buxhetin e vitit të kaluar. Zvogëlimi është rezultat i uljes së të ardhurave nga projektet e siguruara për mbështetjen e migruesve të cilët kalojnë transit nëpër vendin tonë. Të ardhurat e veta të planifikuara nga të ardhurat e përgjithshme, sivjet marrin pjesë me 20,98% dhe në përqindje janë rritur në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa në shumën nominale përfaqësojnë pjesë të njëjta, kurse të ardhurat nga organet dhe donatorët marrin pjesë me 79,02% dhe shënojnë rënie në krahasim me vitin e kaluar kur ato merrnin pjesë me 89,36 %. Të ardhurat nga donatorët shënojnë rënie në shumën nominale si rezultat i mbështetjes së zvogëluar të projektit të migruesve që lëvizin në vendin tonë.

Në pjesën e shpenzimeve, shpenzimet kapitale marrin pjesë me 1,54%, shpenzimet aktuale janë 71,74% dhe shpenzimet për donacione dhe ndihmë shënojnë 26,72% të shpenzimeve të përgjithshme. Edhe sivjet politika e Organizatës është orientuar drejt zhvillimit të organizatave komunale të Kryqit të kuq, për çka janë paraparë mjete të caktuara për mbështetjen e zhvillimit dhe punës aktuale të OKKK-ve, të cilat paraprakisht do të zgjidhen në bazë të kriterëve të caktuar. Nga shpenzimet e përgjithshme të Buxhetit për vitin 2018, 18,14% janë shpenzime për Zyrën qendrore të KKRМ-së, ndërsa 81,86% të Buxhetit të përgjithshëm janë dedikuar për organizatat komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit. Me rëndësi është të përmendet gjithashtu se 25% të shpenzimeve të përgjithshme të Zyrës qendrore janë transferime direkt në OKKK për realizimin e aktiviteteve programore, ndërkaq në shumën nominale shënojnë ulje në krahasim me vitin e kaluar si rezultat i reduktimit të aktiviteteve të projektit të siguruara nga donatorët e huaj dhe të brendshëm për mbështetjen e migruesve në Republikën e Maqedonisë.

Në shpenzimet e Zyrës qendrore të KKRМ-së janë përfshirë shpenzimet e rrogave të punonjësve, shpenzimet materiale, si dhe shpenzimet për mirëmbajtjen aktuale. Në shpenzimet e dedikuara për OKKK-të janë përfshirë shpenzimet për projektet e siguruara nga donatorët apo për programet e siguruara nga institucionet.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë përmes monitorimit të tendencave moderne për modernizimin dhe përsosjen e punës materiale dhe financiare, mundëson transparencë dhe llogaridhënie në punë, përpunim automatik të të dhënave, rrjedhë të shpejtë të informacioneve dhe treguesve financiarë, bazë të saktë dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave financiare dhe rritje të kapaciteteve të Shoqatës nacionale në përgjithësi.

